



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

**STATUTI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE
PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË**

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 2 paragrafi 2, nën paragrafi 2.5 dhe nenit 48, 49, 59 paragrafi 9 të Ligjit Nr.04/L-150 Për Odat e Profesionistëve Shëndetësor (Gazeta zyrtare nr.23/4 Korrik 2013), në mbledhjen e mbajtur me _____ nxjerrë:

STATUTIN E ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË, SHËNDETËSOR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor është organizatë e pavarur profesionale që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.
2. Oda e Infermierëve , Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor është organizatë e pavarur e cila mbron dhe prezanton interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të Kodit Etik dhe Deontologjise mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private, siguron edukimin e vazhdueshem profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë Statut të Odës së Infermierëve , Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë (në tekstin e mëtejme Oda), rregullohet emërtimi, selia organizimi i brendshëm i Odes, anëtarësia në Odë, kompetencat e Odës, organizimi dhe funksionimi i Odës, mbajtja e regjistrit të anëtarëve të Odës, organet e Odës, mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës, përbërja dhe kompetencat e organeve të Odës, përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Odës, procedura para këshillit Etik dhe Gjyqit të nderit të Odës, shqiptimi i masave disiplinore, burimet e financimit të Odës dhe qështjet tjera me rëndësi për punë dhe funksionim të Odës.

Neni 3

Atributet e OIK

1. Oda ka statusin e personit juridik me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë të parapara me Ligjin mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe këtë statut.
2. Oda do të veprojë në emër të vetë dhe do të jetë përgjegjëse për detyrimet e veta me të gjitha pasuritë e tyre.

Neni 4

Emërtimi dhe Selia

1. Emërtimi i odës është: Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë (OIK)
2. Emërtimi i Odës në gjuhën angleze
3. Emërtimi në gjuhën serbe
4. Selia e Odës është në Prishtinë.
5. Odën e përfaqëson dhe reprezentanton Kryetar/ja i/e Odes.

Neni 5

Vula

Oda ka vulën e vet, përcaktimi i formës, përmbajtjes së vules, procedura për mënyren e punimit, përdorimit, ruajtjes si dhe përgjegjësia për përdorimin e vulës bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/ L -54 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore të tij.

Neni 6

Emblema dhe simbolet

1. Emblema e Odës së Infermierëve Mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës është simbol zyrtar i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë.
2. Simboli i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë gëzon mbrojtje ligjore.
3. Emblema zyrtare e Odës miratohet nga Kuvendi i OIK, me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit.

II. ANËTARËSIMI NË ODË

Neni 7

Detyrimi i anëtarësimit

1. Anëtarësimi në Odë është obligativ për të gjithë infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësorë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.
2. Bashkëpunëtorët profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve nga neni 78 i Ligjit për shëndetësi.
3. Anëtarësimi në Odë është obligim edhe për të gjithë profesionistët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte të mbrojtjes sociale institucioneve tjera të organeve shtetërore, në fakultete, gjegjësisht në shkolla profesionale, në ambulanca të mjekësisë së punës si dhe në të gjitha rrethanat tjera ku ushtrohet veprimtaria shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 8

Fitimi i Statusit të anëtarit

1. Statusi i anëtarit të Odës fitohet me regjistrimin në regjistrin qendrorë të anëtarëve të Odës. Procedura e anëtarësimit rregullohet me rregullore.
2. Organet kompetente të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga profesionistët shëndetësorë me vendim lejojnë regjistrimin në regjistrin e profesionistit shëndetësorë.
3. Ndaj vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund të ushtrohet ankesa organit kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Neni 9

Të drejtat e anëtarëve të Odës

1. Anëtarët e Odës kanë të drejta të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në të drejtat e mëposhtme:
 - 1.1. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Odës;
 - 1.2. Të informohen për të gjitha çështjet e punës dhe afarizmit të Odës;
 - 1.3. Që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo ndërmjet përfaqësuesve të vet të japin propozime dhe të shprehin mendimin e tyre për mbrojtjen e interesave dhe integritetit personal dhe të përgjithshëm në ushtrimin e veprimtarisë mjekësore;
 - 1.4. Të shfrytëzojnë, ndihmën materiale të Odës nga fondi i veçantë i solidaritetit, nën kushtet dhe procedurat e parapara me akte të veçanta të Odës;
 - 1.5. Të propozojnë nisma ligjore në përputhje me procedurën e vecantë të përcaktuar me rregullore;
 - 1.6. Të shfrytëzojnë të drejta tjera të parapara me akte të veçanta të Odës.

Neni 10

Obligimet dhe përgjegjësit e anëtarëve të Odës

1. Anëtarët e Odës kanë këto obligime dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Të respektojnë statutin e Odës dhe kodin e etikës profesionale;
 - 1.2. Përbushja e obligimeve mbi taksën administrative të anëtarësimit dhe taksave tjera brenda afatit të paraparë nga Oda;
 - 1.3. Të marrin pjesë rregullisht dhe të kryejn obligimet në organet e Odës në të cilat janë zgjedhur;
 - 1.4. Të respektojnë standardet dhe normat profesionale të shërbimit shëndetësorë që në mënyrë permanente të përfshihen në edukimin e vazhdueshëm profesional;
 - 1.5. Të raportoj rregullisht për të dhënat personale të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e regjistrit të anëtarëve brenda afatit prej 15 ditësh nga ndryshimi i tyre nga të dhënat bazë të ofruara me rastin e anëtarësimit, apo së paku një herë në vit rifreskimin e këtyre të dhënave;
 - 1.6. Shërbimi profesional i Odës, eksoficio të përditësojë regjistrat e anëtarësisë me rastin e shqiptimit të masës së përkohëshme të tërheqjes së licencës;
 - 1.7. Të mbajë në uniformë gjatë shërbimit profesional, kartën e identifikimit të OIK/apo insituicionit ku ushtron veprimtarinë të cilat përmbajnë numrin e licencës të profesionistit shëndetësor;
 - 1.8. Të përbushin obligimet dhe përgjegjësit e tjera të parapara me akte të veçanta të Odës.

Neni 11

Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarëve të Odës ju ndërpritet anëtarësimi në Odë në këto raste:
 - 1.1. Me revokimin e përhershëm të licencës;
 - 1.2. Në bazë të kërkesës së anëtarit të Odës nga dita e marrjes së vendimit nga organi kompetent i Odës për ç'regjistrim nga regjistri i anëtarëve të Odës;
 - 1.3. Në rast të humbjes së zotësisë së veprimit në bazë të veprimit të plotfuqishëm gjyqësor.
 - 1.4. Në rast të mospagesës së anëtarësisë në vazhdimësi gjashtë muaj, me vendimin e organit i cili regjistron anëtarin;
 - 1.5. Në rast të vdekjes së anëtarit të Odës;
 - 1.6. Me rastin e shqiptimi të masave disiplinore të fshirjes nga regjistri i anëtarëve.
2. Anëtarëve të cilëve i është ndërprerë anëtarësimi për shkak të mospërbushjes së taksës administrative mbi anëtarësimin, mund të rianëtarësohen pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve mbi taksat e anëtarësimit nga vitet në të cilat ka qenë anëtarë në përputhje me aktin e vecantë të miratuar nga Kuvendi.

Neni 12

Obligimet e anëtarit në ndërprerjen e anëtarësimit

Anëtarit të Odës që i është ndërprerë anëtarësia me përjashtim të nenit 11 , paragrafi 1.5 është i obliguar që në afat prej 7 ditësh të i dorëzojë Odës kartelën e anëtarësimit dhe vulën personale. Ndaj anëtarëve të cilët nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara me këtë nen, fillohet procedura pranë Këshillit Etik për shkeljen e legjislacionit.

III. KOMPETENCAT E ODËS

Neni 13

Kompetencat – Veprimtaritë publike të odës

1. Kompetencat publike të Odës janë:
 - 1.1. Miraton kodin e Etikës profesionale (Kodin e Etikës);
 - 1.2. Regjistron dhe mirëmbanë regjistrin e profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe të gjitha Institucioneve shëndetësore;
 - 1.3. Lëshimi i licencave, ri-licencimi dhe revokimi i tyre;
 - 1.4. Zbatimi i mbikëqyrjes profesionale me angazhim të eksperteve të lëmive përkatëse;
 - 1.5. Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
 - 1.6. Ushtrojnë mbikëqyrjen profesionale dhe ligjore mbi punën e profesionistëve shëndetësor;
 - 1.7. Planifikojnë, zbatojnë edukimin e vazhdueshëm profesional;
 - 1.8. Ndërmjetëson në kontestet në mes anëtarëve të Odës dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;
 - 1.9. Organizon gjyqet e nderit në lidhje me përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të Odës dhe shqipton masa disiplinore;

- 1.10. Mbikëqyrjen e funksionimit të shërbimeve shëndetësore brenda insitucioneve nga neni 35 (burgjet), 36 (FSK – Policia), 37 (përkujdesi social), 38 (shoqëria civile) i ligjit për shëndetësi;
- 1.11. Cakton lartësinë e anëtarësisë të anëtarëve të Odës;
- 1.12. Cakton lartësinë e taksës për licencim, ri-Licencimit, dhe lejeve tjera për ushtrim të veprimtarisë profesionale në bazë të autorizimeve ligjore;
- 1.13. Lëshon kartelat e identifikimit dhe numrat identifikues për anëtarët e Odës;
- 1.14. Me kërkesën e anëtarëve të Odës lëshon çertifikata, vërtetime dhe dokumente tjera në bazë të evidencës zyrtare të Odës.

Neni 14

Ushtrimi i përgjegjësiwe publike

Përgjegjësitë publike, organet e Odës i ushtrojnë sipas procedurës së paraparë me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 15

Kompetencat tjera të Odës

1. Përveq autorizimeve publike nga neni 9 i Ligjit për Odat e profesionistëve shëndetësor, Oda ushtron edhe këto pune;
 - 1.1 Përfaqëson dhe mbron interesat profesionale të anëtarëve të Odës në ushtrimin e profesionit;
 - 1.2 Kujdeset për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve të Odës në ushtrimin e punëve profesionale në pajtim me etikën profesionale;
 - 1.3 Mbanë evidencën e anëtarëve të Odës që ushtrojnë veprimtarinë private shëndetësore dhe të cilët janë të regjistruar në regjistrin e organit kompetent në pajtim me ligjin;
 - 1.4 Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
 - 1.5 Bashkëpunimi në përgatitjen e ligjeve, dokumenteve si dhe akteve tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
 - 1.6 Propozimi dhe inicimi i procedurave për nxjerrjen e akteve të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me Ligjin , Statutin dhe aktet tjera të Odës;
 - 1.7 Përcaktimi i çmimoreve të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve farmaceutike, në bashkëpunim me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore;
 - 1.8 Përcaktimi i çmimeve të produkteve medicinale në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse;
 - 1.9 Bashkëpunimi në përpilimin e plan-programeve për edukimin e vazhdueshëm profesional për të gjithë profesionistët shëndetësore;
 - 1.10 Zbatimi i aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Odës;
 - 1.11 Përfaqësimi i interesave profesionale dhe sociale të profesionistëve shëndetësore dhe bashkëpunëtorëve tjerë;

- 1.12 Konsultimi, ofrimi i ndihmës dhe përfaqësimi i interesave të anëtarëve në fushën e legjislacionit si dhe lëmive tjera që ndërlidhen me fushën e shëndetësisë;
- 1.13 Pjesëmarrja në vendimmarrje në lidhjen e kontratave me Fondin për Sigurime Shëndetësore;
- 1.14 Krijimi dhe menaxhimi i fondit të Odës;
- 1.15 Bashkëpunon në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale;
- 1.16 Përgatitja dhe lëshimi i formave dhe dokumenteve si dhe i revistave, librave dhe publikimeve tjera;
- 1.17 Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të Odës;
- 1.18 Promovimi dhe zbatimi i aktiviteteve kulturore dhe shoqërore të anëtarëve, organizimi i ngjarjeve kulturore, sportive dhe ngjarje të tjera sociale;
- 1.19 Emërimi i përfaqësuesëve të Odës në marrëveshje me institucionet e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor;
- 1.20. Ofron asistencë ligjore për anëtarët e saj;
- 1.21. Mbron dhe promovon reputacionin e infermierisë dhe profileve të OIK, si dhe reagon në deklaratat e padrejta dhe të pa baza të cilat mund të transmetohen në medium publike;
- 1.22. Përcakton normat dhe standaret e shërbimit infermieror;
- 1.23. Bën barazvlerësimin e programeve në aspektin përmbajtësor dhe kohor, në rast të mospërputhjes së thirrjeve profesionale me thirrjet e parapara me Ligj, duke licencuar në thirrjen më të përparë që njihet ligji;
- 1.24. Zbatimi i aktiviteteve tjera në përputhje me ligjin, këtë statut dhe aktet tjera të përgjithshme të Odës.

IV. ORGANET E ODËS

Neni 16

Organet e Odës

1. Organet e Odës janë:
 - 1.1. Kuvendi;
 - 1.2. Kryetari i Odës;
 - 1.3. Këshilli Drejtues;
 - 1.4. Këshilli Mbikqyrës i Odës;
 - 1.5. Këshilli Etik;
 - 1.6. Gjyqi i Nderit;
 - 1.7. Prokurori i Odës;
 - 1.8. Komisionet e Përhershme të Odës;
 - 1.9. Komisionet funksionale.
2. Mandati i anëtarëve të organeve të Odës të zgjedhur me proces zgjedhor në njësitë zgjedhore është 4 vite, pas skadimit të mandatit mund të rizgjidhen edhe për një mandat katër (4) vjeçarë. Anëtari nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate radhazi.
3. Kompenzimi i shpenzimeve materiale të Odës si dhe kompenzimi për punë të anëtarëve të Odës përcaktohet me akte të veçantë të Odës të aprovuar nga Kuvendi i Odës.
4. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të Odës përcaktohet me rregullore të veçantë.

Neni 17

Kuvendi i Odës

1. Kuvendi është organi më i lartë i Odës i cili ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të parapara me Ligj dhe këtë statut.
2. Mënyra e zgjidhjes dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të Odës përcaktohet me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të Odës dhe të organeve tjera të Odës. (diskutuese celesi perfaqesues te jete ne statut apo me rregullore) – rregullore.
3. Anëtarët e Kuvendit të OIK zgjidhen me votim të drejtpërdrejt në njësitë zgjedhore të përcaktuara nga Komisioni Qëndror Zgjedhor i OIK-së.
4. Institucionet private shëndetësor përfaqësohen në Kuvendin e OIK sipas mënyrës së përcaktuar me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të Odës dhe të organeve tjera të Odës.
5. Me qëllim të formimit më të lehtë të njësisë zgjedhore, shmangiet nga kriteret e numrit të mjekëve të regjistruar në institucionet publike dhe private mund të jenë $\pm 5\%$.
6. Përfaqësimi i anëtarëve nga institucionet tjera, përcaktohet me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të Odës dhe të organeve tjera të Odës.

Neni 18

Papajtueshmëria e kandidimit për Kuvendin e Odës

1. Për anëtarë të Kuvendit të Odës nuk mund të kandidojnë anëtarët të cilët :
 - a. janë të dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje etik të rëndë nga organet e OIK në 5 vitet e fundit;
 - b. janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale kundër detyrës zyrtare dhe shëndetit publik;
 - c. i është shqiptuar masë disiplinore nga institucioni ku ushtron veprimtarinë shëndetësore masë e rëndë në 3 vitet.

Neni 19

Përfundimi para kohe i mandatit të anëtarit të Kuvendit

1. Mandati i anëtarit të Kuvendit të Odës përfundon para kohe kur :
 - a) Nuk jep betimin brenda dy takimeve të njëpasnjëshme të Kuvendit pas certifikimit të rezultatit zgjedhor;
 - b) Jep dorëheqje;
 - c) Përfundon mandati i Kuvendit;
 - d) Me humbjen e statusit të anëtarit të Odës;
 - e) Mungon në tri takime radhazi pa arsye dhe pa njoftim paraprak të Kryetarit të OIK;
 - f) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;
 - g) ajo/ai vdes;
 - h) Nëse ndërrohet njësinë zgjedhore nga e cila ka fituar mandatin ;
 - i) Nëse për përfundimin e mandatit të tij votojnë shumica e anëtarëve të njësisë zgjedhore të cilën përfaqëson anëtari. Procedura dhe iniciativa për realizimin e këtij

votimi inicohet me nismën e 1/3 e anëtarëve të njësisë zgjedhore. Cështjet tjera procedurale përcaktohen me rregulloren për zgjedhje.

2. Me rastin e përfundimit të mandatit të anëtarit të Kuvendit para kohe, anëtarit i pushon secili funksion të cilin e ushtron brenda organeve të cilat zgjedhen nga Kuvendi.
3. Procedura e zëvendësimit të anëtarëve të OIK të cilët përfundojnë mandatin para kohe, përcaktohet me rregulloren e zgjedhjeve.

Neni 19

Kompetencat e Kuvendit

1. Kuvendi është organi më i lartë i Odës, i cili ka këto përgjegjësi dhe autorizime:

- 1.1. Miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe aktet e tjera normative;
- 1.2. Miraton kodin e etikës profesionale;
- 1.3. Miraton programin e punës së Odës;
- 1.4. Miraton rregulloren e punës së Odës;
- 1.5. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin;
- 1.6. Miraton dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës;
- 1.7. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, Zëvendës Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Etik;
- 1.8. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
- 1.9. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit;
- 1.10. Zgjedh dhe shkarkon Prokurorin e Odës;
- 1.11. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të Përherëshme të Odës;
- 1.12. Përcakton lartësinë e anëtarësisë për anëtarët e Odës;
- 1.13. Përcakton lartësinë e kompensimit (taksës) për anëtarët e Odës, taksën për licencim dhe rilicencim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e çertifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mbanë evidence zyrtare;
- 1.14. Përcakton lartësinë e kompensimit për regjistrim në regjistrin e anëtarëve të Odës;
- 1.15. Vendos për lartësinë e mjeteve të ndara për fondin e Odës për ndihmë reciproke të anëtarëve të Odës;
- 1.16. Shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të Odës;
- 1.17. Miraton raportin vjetor të Odës;
- 1.18. Miraton raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Odës;
- 1.19. Miraton raportin mbi punën e Këshillit Drejtues të Odës;
- 1.20. Merr vendim për shkarkim të Kuvendit të Odës dhe shpallë zgjedhjet e parakohshme.
- 1.21. Vendos për anëtarësim të Odës në organizatat ndërkombëtare si motra, merr vendime për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve të Odës;
- 1.22. Shqyrton dhe merr qëndrime parimore për qështjet me rendësi për punën e Odës.

2. Vendimet e Kuvendit nga fushëveprimi i tij, janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme brenda Odës. Vendimet e kuvendit mund të atakohen në procedurën e konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Neni 20

Mbledhjet e Kuvendit

1. Mbledhjet e Kuvendit të Odës janë publike dhe mund të mbahen nëse janë prezent me shumë se gjysma e anëtarëve, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të Odës.
2. Mbledhjen e Kuvendit të Odës e udhëheq Kryetari i Odës.
3. Kuvendi mban së paku një mbledhje gjatë viti kalendarik.
4. Votimi për pikat e rendit të ditës është i hapur përveç në raste kur Kuvendi vendos ndryshe.
5. Statuti i Odës ndryshimet dhe plotësimet e tij miratohen me votimin e 2/3 të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit Odës.
6. Vendimet tjera Kuvendi i merr me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezent.
7. Kuvendi i Odës apo organi tjetër i Odës mund të vendos për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi apo nga një pjesë e tij. Rastet e përjashtimit të publikut përcaktohen me akt të vecantë të Kuvendit mbi mënyrën e punës së organeve.
8. Njoftimet për takimin e Kuvendit bëhen publike, mënyra e publikimit të mbledhjeve të Kuvendit rregullohet me anë të rregullorës së punës.

Neni 21

Mbarëvatja dhe vendimarrja e Kuvendit

Me rregulloren mbi punën e Kuvendit të Odës përcaktohen mënyrat e konvokimit të mbledhjeve të Kuvendit, e udhëheqjes së mbledhjes së Kuvendit dhe mënyra e marrjes së vendimeve , dhe çështje tjera procedurale dhe teknike për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

Neni 22

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit

1. Me propozim të Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, me kërkesen e vetë Kryetarit të OIK ose 1/3 e anëtarëve të Kuvendit Odës, Kryetari/ja i/e Odës është i/e obliguar të thërras mbledhjen e jashtëzakonshme të Odës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit.
2. Në rast të pamundësisë apo refuzimit për thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Kuvendit nga Kryetari/ja, brenda afatit të paraparë në paragrafin 1, mbledhjen e thërret Këshilli Drejtues. Drejtimin e mbledhjes së Kuvendit e bën anëtari më i vjetër i Kuvendit.
3. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të formulohet me shkrim së bashku me materialin e rendit të ditës, që duhet ti dërgohet Kryetarit/es të OIK nëpërmjet shërbimit profesional të OIK.
4. Rendi i ditës i mbledhjeve të jashtëzakonshme nuk i nënshtrohet procesit të votimit dhe nëse të njejtat nuk fillojnë brenda 3 orësh nga fillimi konsiderohen si të përfunduara.

Neni 23

Kryetari/ja i/e Odës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit/es së Odës:
 - 1.1. Përfaqëson Odën dhe vepron në emër të tij/saj;
 - 1.2. Fton dhe udhëheq seancat e Kuvendit;

- 1.3. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyre eksplicite Kuvendit të Odës;
- 1.4. Ekzekuton aktet e Kuvendit të Odës;
- 1.5. I propozon Kuvendit të Odës emërimin dhe shkarkimin e zëvendësëve të tij/saj;
- 1.6. Me propozim të Kryetar/es të Odës, Kuvendi mund të miratojë zv.Kryetarë shtesë nga radhët e anëtarëve të Odës, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësit e tyre me vendim të vecantë;
- 1.7. Organizon punën dhe drejton politikën e Odës;
- 1.8. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin Odës;
- 1.9. Raporton para Kuvendit të Odës për situatën ekonomiko-financiare të Odës, së paku një herë në vit apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Odës;
- 1.10. Aktivitetet tjera që i caktohen me statut;
- 1.11. Në rast mungese Kryetarin/en e Odës e zëvendëson njëri nga zv.kryetarët e Odës, te cilin e autorizon Kryetari/ja me shkrim. Zv.kryetarët mund të ushtrojnë këtë funksion në detyrë jo më shumë se 6 muaj;
- 1.12. Në rast se Kryetari/ja i/e Odës nuk kthehet në funksionin e tij/saj për 6 muaj, Kuvendi i Odës shpall zgjedhjet për Kryetarin e ri brenda afatit prej jo më larg se 45 ditë nga kalimi i afatit 6 mujor;
- 1.13. Kryetari përfaqëson qëndrimin e OIK për publikun, ose personi i autorizuar prej tij;
- 1.14. Cakton përfaqësuesit e OIK në grupet punuese apo nisma tjera, për të cilat informon Këshillin Drejtues;
- 1.15. Kryetari është përgjegjës për zbatimin e Rregullores së Kuvendit dhe bën interpretimin përfundimtar të saj gjatë seancës plenare.

Neni 24

Papajtueshmëria e ushtrimit të funksionit

Kryetari/ja i/e Odës, zëvendës Kryetarët, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Sekretari i përgjithshëm nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione tjera publike dhe politike përveç profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.

Neni 25

Zgjedhja e Kryetarit/ës të Odës

1. Kryetarin/en e Odës e zgjedh Kuvendi i Odës në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyren e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.
2. Kandidati për Kryetar të Odës duhet të plotësojë kriteret minimale si:
 - 2.1. Mbështetjen (nënshkrimet) e së paku 10% të anëtarëve të Kuvendit të Odës;
 - 2.2. Adresimin e programit në KQZ prej _____ në të cilën përshkruhet vizioni dhe objektivat për mandatin të cilin kërkohet besimi. Me rastin e certifikimit këtë program KQZ e dërgon te anëtarët e Kuvendit;
 - 2.3. Të ketë së paku 10 vite përvojë punë në fushën e profileve shëndetësore të OIK;
 - 2.4. Të ketë së paku gradën master nga profilet e OIK;
 - 2.5. Të mos ketë të shqiptuar shkelje etike nga organet etike të OIK së paku për 5 vitet e fundit apo dënim për keqpërdorim të detyrës zyrtare si vepër penale apo kundër shëndetit publik.
3. Mandati i Kryetarit/ës së OIK është 4 vjet.

4. Një anëtarë i OIK nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate funksionin e Kryetarit të OIK.
5. Votimi për Kryetar të Odës, mbahet i fshehtë edhe në rastet kur për këtë funksion ka kandiduar vetëm një anëtarë.
6. Kryetari/ja i/e OIK zgjedhet kandidati i cili në roundin e parë të votimit merr gjysmën +1 e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit.
 - 6.1. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk arrin numrin e mjaftueshëm për tu zgjedhur në roundin e parë, zhvillohet roundi i dytë mes dy kandidatëve më të votuar në roundin e parë në të cilin Kryetar i OIK-ut konsiderohet kandidati i cili ka marrë gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni x.

Shkarkimi

1. Kuvendi i Odës mund të shkarkoj Kryetarin/en e Odës në këto raste:
 1. Vepron në kundërshtim me vendimet e ligjshme të Kuvendit;
 2. Dënohet me vendim përfundimtar për shkelje të rënda etike nga organet etike të OIK;
 3. Dënohet me aktgjykim të formës së prerë për keqpërdorim të detyrës zyrtare apo veprat penale kundër shëndetit publik.

Thirrja e seances për shkarkimin e Kryetarit/ës të Odës

Neni x

1. Procedura e thirrjes së Kuvendit të OIK për shkarkimin e Kryetarit/ës të OIK, fillon me propozimin e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të OIK.
2. Kërkesës për thirjen e Kuvendit të OIK për shkarkimin e Kryetarit/ës i bashkangjitet dokumenti i cili dëshmon përmbushjen e kriterëve nga paragrafi I-rë.
3. Kuvendi i OIK, thirret sipas procedurës së përcaktuar nga neni 22, paragrafet 2 dhe 3.
4. Kërkesa për shkarkim konsiderohet e miratuar nëse për të votohen nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të OIK.
5. Në rast se kuvendi dështon të miratojë shkarkimin e Kryetarit/es të OIK, një kërkesë me arsyetim tjetër për shkarkim mund të paraqitet pas nëntëdhjetë ditëve të ardhshme.

Neni X

Shkarkimi i zv. Kryetareve

Propozimi për shkarkimin e zv. Kryetarit të OIK mund ta bëjë vetëm Kryetari/ja i/e OIK, dhe një propozim i tillë konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

Neni 26

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ i Odës i përbërë nga 11 anëtarë që ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat të parapara me ligj, këtë statut, dhe aktet tjera normative të Odës .
2. Këshilli Drejtues i Odës:
 - 2.1 Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Odës;
 - 2.2 Përcakton propozimin e statutit dhe akteve tjera të Odës;
 - 2.3 Propozon Kuvendit anëtarët e organeve të Odës;
 - 2.4 Përcjellë dhe harmonizon punën e organeve të Odës;
 - 2.5 Përcakton propozimin e programit të punës së Odës;
 - 2.6 Propozon organeve shtetërore masat për mbrojtjen dhe përparimin e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësore;
 - 2.7 Përcakton planin financiar të Odës dhe kujdeset për zbatimin;
 - 2.8 Emëron komisionet funksionale për shqyrtimin dhe për përgatitjen e nismave legjislative, si dhe për çështje tjera të një rëndësie të veçantë nga fushëveprimi i cili me aktet legjislative të OIK nuk është i përcaktuar për asnjë organ, me mandat të përcaktuar sipas vendimit nga Këshilli Drejtues;
 - 2.9 Miraton llogaritë periodike financiare;
 - 2.10 Vendos lartësinë e kompenzimeve për anëtarët e organeve të Odës dhe shërbimit profesional;
 - 2.11 Emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm të Odës në bazë të konkursit publik;
 - 2.12 Shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës së Odës në fushat për të cilat është përgjegjëse;
 - 2.13 Miraton rregulloren mbi organizimin dhe sistematizim e punëve të shërbimit profesional të Odës dhe merr masa për sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetin e punës të shërbimit profesional;
 - 2.14 Vendos në shkallë të dytë sipas ankesave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të shërbimit profesional të Odës;
 - 2.15 Kryen dhe punë tjera të parapara me statut të Odës.

Neni 27

Përbërja e Këshillit Drejtues

1. Kryetari/ja dhe zëvendës kryetarët e Odës janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
2. Anëtarët tjerë të Këshillit Drejtues i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të vet.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues i zgjedh Kuvendi i Odës në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Odës është person i ftuar gjithmonë në takimet e Bordit Ekzekutiv Këshillit Drejtues.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Odës nuk ka të drejtë vote por ka të drejtë për të propozuar pika në rendin e ditës dhe dokumentet mbështetëse të tyre.

Neni 28

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit Drejtues.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjatë katër vite dhe përputhet me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.
3. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheqë Kryetar i/ ja i/e Këshillit Drejtues. gjedhja e kryetarit te KD behet nga Kuvendi.
4. Pikat e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe materialet lidhur me to i përgatitë Kryetari/ja i/e Këshillit Drejtues në bashkëpunim me Kryetarin/en e Odës.
5. Këshilli Drejtues mban mbledhje të rregullta së paku një herë në muaj.
6. Në mungesë të Kryetarit/es të Këshillit Drejtues mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheq ~~udhëheq njëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues.~~ zv. Kryetari i Këshillit Drejtues/ Kryetari/ja i/e Odës
7. Këshilli Drejtues për punën e vete i përgjigjet Kuvendit të Odës.
8. Mënyra e punës së Këshillit Drejtues përcaktohet me akte të veçanta.
9. Këshilli Drejtues i paraqet raport me shkrim Kuvendit për punën e tij së paku një herë në vit apo kurdo që kërkon Kuvendi me 1/3 e anëtarëve apo në raste të jashtëzakonshme.
10. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të ushtrojnë funksione tjera brenda komisioneve të përhershme të Odës.

Neni

Neni 29

Këshilli Mbikëqyrës i Odës

1. Këshilli Mbikëqyrës i Odës:
 - 1.1 Mbikëqyrë dhe përcjellë afarizmin financiar të Odës;
 - 1.2 Përcjell dhe mbikëqyrë realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të Odës;
 - 1.3 Mbikëqyrë dhe përcjell punën e shërbimit profesional të Odës;
 - 1.4 Propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet financiare kur vlerëson se ka shkelje ligjore dhe të akteve të miratuar nga Kuvendi i Odës.
 - 1.5 Ndërmerr aktivitete mbikëqyrëse nga fushëveprimi i tij me kërkesen e Kryetarit/ës të Odës, Këshillit Drejtues apo 1/3 të anëtarëve të Kuvendit;
 - 1.6 Kryen dhe punë tjera të parapara me statut dhe me akte tjera të Odës.

Neni 30

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshillin Mbikëqyrës të Odës e përbëjnë 7 anëtarë.
2. Kryetarin/en zv.kryetarin/en dhe anëtarët e tjerë të Këshillit i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të vetë në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.
3. Këshilli Mbikëqyrës i Odës për punën e vete i përgjigjet Kuvendit të Odës ~~së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë Shëndetësor.~~

Neni 31

Këshilli Etik

1. Këshilli Etik:
 - 1.1 Mbikëqyr zbatimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
 - 1.2 Siguron udhëheqjen etiko-morale deontologjike dhe promovon principet dhe parimet e etikës profesionale;
 - 1.3 Merr masat e duhura në rast të shkeljes së Kodit Etik dhe të Deontologjise mjekësore;
 - 1.4 Pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetarëve;
 - 1.5 Jep mendimet dhe vlerësimet për punën e anëtarëve të Odës në pajtim me Kodin e etikës profesionale;
 - 1.6 I ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e së drejtës së cilësisë së shërbimeve, llojit dhe përmbajtjes së shërbimeve;
 - 1.7 Kryen dhe punë tjera të parapara me statut të Odës si dhe me akte te veçanta të Odës;
 - 1.8 Këshilli etik ka 5 anëtarë;
 - 1.9 Kryetarin/ën, zv.kryetarin/ën dhe tre anëtarët e tjerë të Këshillit Etik i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të Odës në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.

Neni 32

Masat Disiplinore

1. Këshilli Etik është organ i shkallës së parë i cili fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së profesionistëve shëndetësorë për shkelje të këtij Ligji, Statutit të Odës dhe Kodit të Etikës mjekësore dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara shqipton këto masa:
 - 1.1 Rekomandim kolegial;
 - 1.2 Kërkim falje ndaj pacientit;
 - 1.3 Qortim ose qortim publik;
 - 1.4 Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
 - 1.5 Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;
 - 1.6 Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës ose fshirja e profesionistit shëndetësorë nga regjistri;
 - 1.7 Kompensimin e dëmit të pacientit kur është e përshtatshme;
 - 1.8 Denimi me të holla njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.

Neni 33

Afatet dhe procedura para Keshillit Etik

1. Në procedurën para Këshillit Etik të Odës zbatohen dispozitat dhe rregullat e procedurës së përgjithshme administrative, në lidhje me thirrjen e palëve, sigurimin e provave, përgatitjen e procesverbaleve, dëgjimin e palës dhe procedurave tjera.
2. Anëtari i Odës ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet ti mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë Këshillit Etik.
3. Në procedurën e marrjes në pyetje të anëtarëve të Odës dhe vlerësimit të provave në procedurën disiplinore para Këshillit Etik mbahet procesverbali.
4. Sipas ankesës ndaj vendimit të Këshillit Etik vendos Gjygyji i Nderit.
5. Procedura pranë Këshillit Etik, nuk mund të filloj në rast se kanë kaluar më shumë se 9 muaj nga shkelja e supozuar profesionale e anëtarit të OIK-ut. Në këto raste me vendim

refuzues Këshilli Etik mbyll procedurë.

6. Këshilli Etik pas pranimit të ankesës brenda 60 ditësh nxjerr vendimin meritor për ankesën.
7. Fillimi i procedurës para Gjyqit të Nderit për përcaktimin e shkeljeve të anëtarit të Odës nga neni 32, paragrafi 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 nuk mund të filloj pas skadimit të një viti nga dita e shkeljes profesionale dhe shkeljes së nderit të anëtarit të Odës.
8. Deri në vërtetësinë e dyshimit të bazuar, anëtari i Odës i cili është në procedurë është i pafajshëm dhe i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara me këtë Statut, përveq nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

Neni 34

Procedura e shqiptimit te masave disiplinore

Kriteret më të përafërta për përcaktimin e shkeljeve, procedurën për përcaktimin e përgjegjësive të Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor për shkelje të këtij Statuti të Odës dhe Kodit të Etikës Mjekësore përcaktohen me akte të veçanta të Odës.

Neni 35

Gjyqi i Nderit

1. Gjyqi i Nderit i Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor është organ i Odës së ~~Infermierëve Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësor~~ që ushtron funksionet e përcaktuara me Ligj, me këtë statut dhe aktet tjera normative të Odës.
2. Ndaj vendimit përfundimtar me të cilën është shqiptuar masa disiplinore nga neni 32 paragrafi 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 i këtij ~~Statuti të Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor~~ mund të ushtrojnë ankesë pranë Gjyqit të Nderit të profesionistëve shëndetësor.
3. Gjyqi i Nderit vendosë lidhur me ankesat e anëtarëve të Odës dhe parregullsive në procesin e zgjedhjeve të organeve të Odës ;
 - 3.1. Gjyqi i nderit trajton ankesat e anëtarëve në afat prej 15 ditësh ndaj vendimeve të cilat mund të çenojnë të drejtat e tyre në kuadër të :
 - 3.1.1. Vendimeve të KQZ-së të nxjerra ndaj vendimarrjes të KNJZ- ve në proceset zgjedhore.
 - 3.1.2. Kundër vendimeve të organeve të cilat kanë vendosur në ankesë në shkallë të parë, përjashtimisht vendimet e Kuvendit të OIK të cilat atakohen vetëm në procedurën e konfliktit administrativ.
4. Gjyqi i Nderit ka pesë anëtarë, Kryetarin/ën, zëvendësin/ën e tij/saj dhe tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyren e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.
5. Një anëtarë dhe zëvendësin e tij/saj e propozon Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 36

Prokurori/ja i/e Odës

1. Prokurori/ja i/e Odës është organ i pavarur për inicimin e procedurës ndaj anëtarëve të Odës ndaj të cilëve ekziston dyshimi i bazuar se ka bërë shkelje të ligjit, statutit dhe Kodit të Etikës Infermiere në aspektin e shkeljeve profesionale infermiere dhe profileve te OIK.

2. Rastet e shkeljes nga neni 32 i këtij Statuti mund ti denoncojnë: Oda e Profesionistëve Shëndetësorë, Ministria e Shëndetësisë, Shoqatat e Infermierëve Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë, Shoqatat e Profesionistëve Shëndetësorë, Institucionet Shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prokuroria Shtetërore, anëtarët e Odës dhe pala e dëmtuar.
3. Prokurorin/ën dhe zëvendësin e tij/saj e zgjedh Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të Odës në pajtim me rregulloren mbi procedurat e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.
4. Prokurori/ja i/e Odës për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Odës.

Neni xxx

Shkarkimi i anëtarëve të organeve (Këshilli Drejtues, Këshilli Mbikëqyres, Këshilli Etik, Gjyqi i Nderit, Prokurori/ja i/e Odës)

1. Procedura e shkarkimi të anëtarit të organeve inicohet me kërkesën e Kryetarit/ës të Odës, Këshilli Drejtues, $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të organit përkatës apo me iniciativën e $\frac{1}{3}$ e anëtarëve të Kuvendit të Odës për shkak të mos efikasitet apo pengimit të punës së organit.
2. Anëtarë i organit të Odës konsiderohet i shkarkuar nëse për këtë kanë votuar shumica e anëtarëve prezent të Kuvendit të Odës.
3. Për shkarimin e Prokurorit/ës të Odës iniciimi bëhet nga Kryetari/ja i/e Odës dhe Këshilli Drejtues.

Neni 37

Komisionet e Përhershme të Odës

1. Oda e ~~Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor~~ ka Komisionet e Përhershme dhe të Përkohshme.
2. Anëtarët e Komisioneve të Kuvendit të Odës i zgjedh Kuvendi i Odës nga radha anëtarëve të Odës, në pajtim me këtë statut dhe me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Odës dhe organeve tjera.

Neni 38

1. Komisionet e Përhershme të Odës janë:
 - 1.1 Komisioni për çështje etike;
 - 1.2 Komisioni për licencim;
 - 1.3 Komisioni për edukim specialistik;
 - 1.4 Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
 - 1.5 Komisioni për praktikën private profesionale;
 - 1.6 Komisioni për buxhet dhe financa;
 - 1.7 Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Neni 39

1. Komisionet e Përhershme të Odës zgjedhen nga Kuvendi i Odës sipas propozimit të Këshillit Drejtues.
2. Anëtarët e Komisioneve të përhershme të Odës mund të jenë anëtarë vetëm të një komisioni të përhershëm.

3. Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme i fton dhe udhëheqë Kryetari i Komisionit.
4. Komisionet e Përhershme së paku 2 herë në vit raportojnë për punën e tyre Këshillit Drejtues dhe Kuvendit të Odës.
5. Përbërja dhe fushëveprimi i komisionit nga neni 38 i këtij statuti përcaktohen me akte të veçanta normative.

BURIMET E FINANCIMIT TË ODËS

Neni 40

~~Financimi i Odave sigurohet dhe menaxhohet nga buxheti i Republikës së Kosovës konform nenit 38 dhe 41 të Ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësor.~~

Neni 41

1. Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor realizon të hyra vetanake nga:
 - 1.1. Anëtarësia;
 - 1.2. Kompensimi (taksës) për anëtarët e Odës, taksën për licencim dhe ri-licencim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mbanë evidence zyrtare;
 - 1.3. Dhuratat dhe donacionet e tjera si dhe të hyrat tjera në pajtim me ligjin;
 - 1.4. Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore);
 - 1.5. Të hyrat e përcaktuara me akte të vecanta të odës.

Neni 42

1. Anëtarët e Odës kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, kompensimin për regjistrim, licencim dhe shërbimet e tjera administrative në pajtim me ligjin dhe aktet tjera normative të Odës.
2. Në rast dështimi të përmbushjes së këtyre obligimeve, organet e Odës marrin masa disiplinore ndaj anëtarëve të saj.
3. Me akt të veçantë të Odës do të përcaktohet lartësia e kompensimit (taksës) për anëtarët e Odës, taksës për licencim dhe ri-licencim si dhe e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare.

Neni 43

Llogaria dhe përgjegjësia financiare

1. Mjetet e Odës udhëhiqen në xhirollogarinë e Odës.
2. Kryetari/ja i/e Odës është përgjegjës financiar i Odës.
3. Oda është përgjegjëse për punën e saj dhe tërë pasurinë që disponon.
4. Menaxhimi financiar i OIK rregullohet me akt të veçantë të Kuvendit në përputhje me këtë Statut.

Neni 44

1. Oda hap llogari të vetën, menaxhon mjetet e dedikuara në fondin e solidaritetit dhe ndihmës reciproke të anëtarëve të Odës.

2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përdoren për ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë të anëtarëve të Odës, dhe të anëtarëve të familjes së tyre në rast fatkeqësie, për sigurim të Odës të bartësve të sigurimit të pasurisë të personave në rast të lëshimeve profesionale si dhe aftësimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të Odës në pajtim me këtë ligj, statutin dhe aktet e tjera të Odës.
3. Fondi i solidaritetit përcaktohet në vartësi nga kapaciteti financiar i Odës me vendim të vecantë të Këshillit Drejtues.

Neni 45

Mjetet nga fondi solidaritetit mund të përdoren edhe për sigurimin e pasurisë së Odës, edukimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të Odës.

Mjetet nga donacionet dhe dhuratat nuk mund të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të Odës përveç në rastet kur shprehimisht janë të destinuara për këtë qëllim.

TRANSPARENCA E PUNËS SË ODËS

Neni 47

Transparenca e punës së Odës

1. ~~Oda e Infermierëve Mamive dhe Professionistëve tjerë Shëndetësor~~ Oda obligohet që të njoftoj opinionin mbi çështjet e rëndësishme nga fushëveprimi i Odës.
2. Oda ka për obligim të njoftoj organet kompetente të ndjekjes, organet kompetente gjyqësore dhe Ministrinë përkatëse për Shëndetësi për procedurën disiplinore që udhëhiqet ndaj anëtarëve të Odës nga organet e Odës si dhe procedurën e Licencimit, Rilicencimit dhe revokimit të licencës nëse dyshohet se në këto procedura ekziston dyshimi i bazuar që është kryer vepër penale.
3. Oda ka për obligim që me kërkesë të organeve nga paragrafi 2 i këtij neni t'i vëjë në dispozicion të gjitha faktet dhe informatat që posedon.

Neni 48

Bashkëpunimi me organet tjera

Oda bashkëpunon me institucionet arsimore të profilit shëndetësor, institucionet shëndetësore, shoqatat e profesionistëve shëndetësore, fondet e sigurimeve shëndetësore lidhur me çështjet e rëndësishme për punët e Odës dhe të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

Neni

Transparenca e mbledhjeve të organeve

1. Mbledhjet e Kuvendit dhe organeve tjera të Odës janë të hapura për opinion.
2. Kuvendi i Odës apo organi tjetër i Odës mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi apo nga një pjesë e tij në rastet kur takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare, si dhe informacione të ndjeshme personale apo komerciale.
3. Njoftimet për takimin e Kuvendit bëhen publike.
4. Me rregulloren të veçantë parashihet procedura e njoftimeve publike për takimet e Kuvendit dhe organeve tjera.

MBIKËQYRJA E PUNËS SË ODËS

Neni 49

1. Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së Odës në ushtrimin e funksioneve publike nga neni 9 i Ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësorë e bënë Ministria e Shëndetësisë.
2. Në ushtrimin e mbikëqyrjes nga paragrafi 1 e këtij neni Ministria e Shëndetësisë mund të kërkon nga organet e Odës raport dhe informata për çështje të caktuara.
3. Oda është e obliguar që raportet dhe informatat nga paragrafi 2 e këtij neni ti ofroj Ministrisë së Shëndetësisë në afat prej 30 ditësh nga dita e kërkesës, ose të informoj për arsyet për të cilat nuk është e mundur të dërgojë brenda afatit të kërkuar.
4. Oda është e obliguar që deri më 31 mars të vitit vijues të dërgoj Ministrisë së Shëndetësisë raportin vjetor për vitin paraprak.
5. Oda është e obliguar ti nënshtrohet auditimit të pavarur të jashtëm për gjdo vit të funksionimit.

AKTET E PËRGJITHSHME TË ODËS

Neni 51

1. Aktet e përgjithshme të Odës janë Statuti, Kodi i Etikës Profesionale, Rregulloret e ndryshme, Udhëzimet dhe aktet e tjera të organëve të Odës të cilat kanë të bëjnë me çështje të përgjithshme të anëtarëve.
2. Aktet e përgjithshme të Odës duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe këtë statut.
3. Iniciativën për nxjerrje dhe ndryshim të akteve të përgjithshme të Odës mund të marrin organet e Odës sipas procedurës së përcaktuar me akt të veçantë.
4. Miratimit të akteve të përgjithshme të Odës duhet ti paraprijë debati publik me komunitetin infermieror, forma e realizimit të debatit publik përcaktohet me rregullore të vecantë
5. Procedura e inicativave për nxjerrjen e akteve ligjore të Odës rregullohet me akt të vecantë të miratuar nga Këshilli Drejtues i Odës.

Miratimi i Statutit nga Ministria e Shëndetësisë

1. Ministria e Shëndetësisë e jep pëlqimin në statutin e Odës në pjesën që kanë të bëjnë me autorizimet publike të Odës nga neni 9 ligjit mbi Odat mjekësore.
2. Në rast se Ministria e Shëndetësisë nuk deklarohet në afat prej 30 ditësh për projektstatutin, konsiderohet se është pajtuar me këtë statut.

SHËRBIMI PROFESIONAL I ODËS

Neni 52

1. Zyra Administrative ushtron veprimtarinë e mëposhtme:
 - 1.1 Ushtrimin e detyrave administrative dhe profesionale:
 - 1.1.1 Regjistrimin, licencimin dhe autorizimin e profesionistëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor e që nuk janë anëtarë të Odave;

- 1.1.2 Mbajtjen e regjistrit të profesionistëve shëndetësor;
- 1.1.3 Aktivitete të tjera që Odat mund t'i delegojnë Zyrës Administrative;
- 1.1.4 Ushtron edhe detyra tjera administrative nga neni 8 dhe 9 i Ligjit mbi Odat e profesionistëve Shëndetësor;
- ~~1.1.5 Detyrat duhet të kryhen në bazë të kontratës për shërbimin ndërmjet Odave dhe Zyrës Administrative.~~

Neni 53

1. Organizimi dhe puna e zyrës administrative përcaktohet me akte të veçanta për organizimin dhe sistematizimin e punëve të miratuara nga ~~Kuvendi i Odës~~ Këshilli Drejtues i OIK.
2. Të punësuarit në zyrën administrative të Odës i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet të përcaktuara me Ligjin e punës, këtë statut dhe aktet tjera të Odës.
3. Punën e zyrës administrative e udhëheqë sekretari i përgjithshëm i Odës .

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 54

~~Bordet ekzistuese në Ministrinë e Shëndetësisë që kanë në kompetencë dhe përgjegjësi çështjet e etikës profesionale, të regjistrimit dhe licencimit të edukimit të vazhdueshëm profesional dhe të edukimit specialistik vazhdojnë së funksionuari gjerë në aprovimin e akteve të veçanta normative që rregullojnë këto fusha të përgjegjësive të Odës dhe emërimin e anëtarëve të ri të Komisioneve përkatëse.~~

Neni 55

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Statutit shfuqizohet dispozitat e akteve juridike të OIK- të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti.
2. Termet dhe procedurat e përcaktuara në këtë statut për organet e OIK-, do të zbatohen përshtatshmërisht për të gjitha organet për të cilat nuk janë rregulluar procedura të veqanta.
3. Çështjet procedurale në zbatim të dispozitave të këtij statuti, rregullohen me akt të vecantë.
4. Zbrazëirat juridike të cilat mund të krijohen dhe nuk janë të parapara me këtë Statut apo me akte te vecanta, interpretohen nga Këshilli Drejtues në përputhje me rregullimin e Odave tjera.

Neni 56

1. Ky Statut hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit të Ministrit të Shëndetësisë, apo pas kalimit të afatit për deklarim të Ministrisë.